

Wk

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-11514
Më 23.10.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 23.10.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike rreth lejimit të shpalljes së tenderit për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve, trotuareve dhe shesheve në qytet, për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve nëpër fshatra, si dhe për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbërua publike, shesheve dhe drunjve dekorativ, dhe mori këtë

KONKLuzion

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike rreth lejimit të mirëmbajtjes verore dhe dimërore të rrugëve, trotuareve dhe shesheve në qytet, të mirëmbajtjes dimërore të rrugëve nëpër fshatra, si dhe për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbërua publike, shesheve dhe drunjve dekorativë, pajisjeve, Lumëbardhit, etj., kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.


Lidhja e kontratës me fituesin e tenderit (operatorin ekonomik) do të bëhet për një periudhë trevjeçare (kontratë kornizë).

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-11514
Më 23.10.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e mjeteve financiare për projektin e menaxhimit të mbeturinave të ngurta në Komunën e Prizrenit, kryetari i Komunës më 23 tetor 2012, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e mjeteve financiare për fituesit e konkursit të datës 1.6.2012 lidhur me logon dhe sloganin për projektin e menaxhimit të mbeturinave të ngurta në Komunën e Prizrenit. Kështu që, për këtë qëllim dhe në emër të shpërblimit për fituesit e konkursit të lartcekur lejohen mjetet financiare dhe atë për:

1. Mehtap Bellodën, lejohen mjetet në shumën prej 100 €.
2. Nora Krasniqin, lejohen mjetet në shumën prej 100 € dhe
3. Gjashtë (6) copë libra lejohen mjetet në shumën prej 50 €.

Shuma e përgjithshme që lejohet për këto shpërblime është 250 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Neni 3


Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-11514
Më 23.10.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 23.10.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, të datës 16.10.2012, rreth lejitimit të shpalljes së tenderit për ndërtimin e kanalizimit në fshatin Nashec, dhe mori këtë

KONKLuzion


Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 16.10.2012, rreth lejitimit të ndërtimit të kanalizimit fekal në fshatin Nashec, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Kadri Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-11514
Më 23.10.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 23.10.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, të datës 9.10.2012, rreth lejitimit të shpalljes së tenderit për ndërtimin e disa rrugëve lokale, kanalizimeve dhe mureve mbrojtëse, me participim, në Komunën e Prizrenit, dhe mori këtë:

KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 9.10.2012, rreth lejitimit të ndërtimit të disa rrugëve lokale, kanalizimeve dhe mureve mbrojtëse, me participim, në Komunën e Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit për ndërtimin e:

1. Kanalizimit në rr. "Mbreti Zog" (Dora Weis),
2. Murit mbrojtës në fshatin Skorobisht,
3. Murit mbrojtës në fshatin Drajçiç,
4. Kanalizimit në fshatin Caparc,
5. Ndërtimin e rrugëve lokale në fsh. Shpenadi-Lagja Shtufi, Çollaku dhe Veseli;
6. Ndërtimin e rrugës me elemente të betonit në fshatin Malësi e Re.


Për realizimin e këtyre projekteve, Komuna e Prizrenit do të participojë me 70 % të vlerës së projektit, ndërsa komuniteti me 30 %.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, komuniteti, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. Dr. Rrahman Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-11514
Më 23.10.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 23.10.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e nënkryetarit të Komunës rreth ndryshimit dhe plotësimit të Aktvendimit nr. 01-011-8493, të datës 31 korrik 2012, dhe mori këtë:

KONKLUZION

I. Miratohet propozimi i nënkryetarit të Komunës rreth ndryshimit dhe plotësimit të Aktvendimit nr. 01-011-8493 të datës 31 korrik 2012, lidhur me formimin e grupit punues për hartimin e PVLB, kështu që në vend të Ruzhdi Rexhës, si anëtar i këtij komisioni, emërohet Ramadan Tafallari.

II. Pjesët e tjera të Aktvendimit nr. 01-011-8493, të datës 31 korrik 2012, mbesin të pandryshuara.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen nënkryetari i Komunës dhe të emëruarit.

Me këtë konkluzion të njoftohen nënkryetari i Komunës dhe të emëruarit, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

The image shows an official circular stamp of the Prizren Municipality. The stamp contains the text: "REPUBLIKA E KOSOVËS", "KOMUNA E PRIZRENIT", "BELEDIJA", "PRIZREN", "Kryetari i Komunës". Overlaid on the stamp is a handwritten signature in black ink, which appears to be "Ramadan Muja".

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-11514
Më 23.10.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të nënkryetarit të Komunës rreth lejitimit të udhëtimit zyrtar për në Podgoricë të Republikës së Malit të Zi dhe pagesës së mëditjeve për Ramadan Tafallarin, Galip Belallarin, Shpresa Osmanollajn dhe Pajtim Kosovën, kryetari i Komunës, më 23 tetor 2012, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i nënkryetarit të Komunës, për lejitimin e udhëtimit zyrtar të Ramadan Tafallarit, Galip Belallarit, Shpresa Osmanollajt dhe Pajtim Kosovës në Podgoricë të Republikës së Malit të Zi, me qëllim të pjesëmarrjes në trajnimin që ka të bëjë me projektin "Rrjeti i Planifikimit Lokal të Veprimit në Biodiversitet në Ballkanin Perëndimor (SEE BAP II). Trajnimi do të mbahet nga data 28 tetor deri me 2 nëntor 2012, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurit.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: nënkryetari i Komunës, Drejtorja e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: nënkryetari i Komunës, Drejtorja e Ekonomisë dhe Financave, të lartcekurit, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-11514
Më 23.10.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të nënkryetarit të Komunës, rreth lejitimit të udhëtimit zyrtar për në Durrës të Republikës së Shqipërisë dhe pagesës së mëditjeve të një delegacioni të Komunës së Prizrenit, kryetari i Komunës, më 23 tetor 2012, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i nënkryetarit të Komunës për lejitimin e udhëtimit zyrtar të një delegacioni të Komunës së Prizrenit në përbërje: Prof. dr. Ramadan Muja-kryetar i Komunës, Orhan Lopar, nënkryetar për komunitete, Njazi Kryeziu, kryesues i Kuvendit, Sadik Paqarizi, drejtor i DUPH, Samir Hoxha, drejtor i DZHET dhe Ajradin Alija, menaxher i Zyrës për Komunitete për në Durrës të Republikës së Shqipërisë. Qëllimi i këtij udhëtimi është pjesëmarrja në projektin që ka të bëjë me konsultimet ndërkomunale, e që do të mbahet nga data 9 nëntor deri me 11 nëntor 2012. Kështu që, për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurit.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: nënkryetari i Komunës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: nënkryetari i Komunës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, të lartcekurit, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-11514
Më 23.10.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të nënkryetarit të Komunës për shpërndarjen e shpenzimeve të telefonisë mobile Vala për muajin shtator, kryetari i Komunës më 23 tetor 2012, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Lejohet shpërndarja e shpenzimeve të telefonisë mobile VALA të faturuara për muajin shtator 2012 për:

- a. Drejtorinë e Administratës për 138 veta.....370,9787 €,
- b. Drejtorinë e Arsimit dhe Shkencës për 80 veta200,00 € dhe
- c. Drejtorinë e Shëndetësisë-QKMF për 29 veta.....72,50 €.

Neni 2


Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: nënkryetari i Komunës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 3

Me këtë Vendim të njoftohen: nënkryetari i Komunës, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-11514
Më 23.10.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 23.10.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, të datës 18.10.2012, rreth lejimit të shpalljes së tenderit për kyçjen e kanalizimit të objekteve të banimit social në rrjetin e kanalizimit të qytetit, dhe mori këtë

KONKLuzion

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, i datës 18.10.2012, rreth lejimit të ndërtimit dhe kyçjes së kanalizimit të objekteve të banimit social në rrjetin e kanalizimit të qyteti, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

The image shows an official circular stamp of the Prizren Municipality. The stamp contains the text: "REPUBLIKA E KOSOVËS", "KOMUNA E PRIZRENIT", "BELEDIYESI", "Kryetari i Komunës". Overlaid on the stamp is a handwritten signature in black ink, which appears to be "Prof. dr. Ramadan Muja".

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-11514
Më 23.10.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, të datës 18.10.2012, rreth lejimit të mjeteve për organizimin e një punëtorie në nivel regjional lidhur me hartimin e statutit të QPS-së, kryetari i Komunës më 23 tetor 2012, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, i datës 18.10.2012, rreth lejimit të mjeteve financiare për organizimin e një punëtorie në nivel regjional lidhur me hartimin e Statutit të QPS-së, kështu që për këtë qëllim, lejohen mjetet financiare në shumën prej 300 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.


Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-11514
Më 23.10.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, të datës 16.10.2012, rreth lejimit të mjeteve financiare për organizimin e një akademie solemne me të gjitha shkollat e Komunës së Prizrenit, lidhur me shënimin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, kryetari i Komunës më 23 tetor 2012, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, i datës 16.10.2012, rreth lejimit të mjeteve financiare për organizimin e një akademie solemne me të gjitha shkollat e Komunës së Prizrenit, lidhur me shënimin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë.

- a. Për shpenzimet e sallës (me ngrohje) lejohen mjete në shumën prej.....250 €,
- b. Për shpërblimet e tre nxënësve dhe për jurinë lejohen mjetet në shumën 250 €, dhe
- c. Për organizimin e një kokteji lejohen mjetet në shumën prej..... 250 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.


Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-11514
Më 23.10.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 23.10.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Inspektorateve, të datës 16.10.2012, rreth lejimit të shpalljes së tenderit për trajnime lidhur me ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit, dhe mori këtë

KONKLuzion


Miratohet propozimi i Drejtorisë së Inspektorateve, i datës 16.10.2012, rreth lejimit të organizimit të trajnimeve lidhur me ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Inspektorateve dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Inspektorateve, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Rrahman Muja

The image shows a circular official stamp of the Municipality of Prizren, Kosovo. The stamp contains the text: "REPUBLIKA E KOSOVËS", "KOMUNA E PRIZRENIT", "Kryetari i Komunës", and "Prof. dr. Rrahman Muja". A handwritten signature in black ink is written over the stamp.

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-11514
Më 23.10.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, rreth lejimit të udhëtimit zyrtar për në Sofje të Republikës së Bullgarisë dhe pagesës së mëditjeve për Kujtim Gashin, kryetari i Komunës, më 23 tetor 2012, miratoi këtë:

VENDIM

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Kujtim Gashin për në Sofje të Republikës së Bullgarisë, me qëllim të pjesëmarrjes në një vizitë studimore që ka të bëjë me hartimin dhe zbatimin e Ligjit për Rini dhe Fëmijë, që do të mbahet nga data 21 tetor deri me 24 tetor 2012, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurin.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-11514
Më 23.10.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas kërkesës së Astrit Gashit nga fshati Atmagjë, , kryetari i Komunës, më 23 tetor 2012, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet kërkesa e Astrit Gashit nga fshati Atmagjë rreth lejitimit të mjeteve për mbulimin e shpenzimeve të derivateve (karburante) lidhur me bartjen me veturë të fëmijës së tij Admir Gashi (nxënës invalid) nga shkolla e Atmagjes deri në shkollën e Arbanës dhe anasjelltas. Kështu që, në emër të mbulimit të shpenzimeve të derivateve, i lejohet Astrit Gashit, i ati i Admir Gashit-nxënës invalid, që të furnizohet me karburant-naftë në lartësi deri në 350 litra karburant –naftë, te operatori ekonomik, i cili bën furnizimin e Komunës me karburante dhe atë për vitin akademik 2012-2013;

Obligohet Sektori Teknik i Drejtorisë së Administratës që të realizojë këtë Vendim.

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Administratës –Sektori Teknik, dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.


Neni 3

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Administratës-Sektori Teknik, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale si dhe arkivi.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-11514
Më 23.10.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 23.10.2012 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor të datës 22.10.2012, rreth lejimit të shpalljes së tenderit për rregullimin e infrastrukturës në fshatin Prevallë, dhe mori këtë

KONKLuzion

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, i datës 22.10.2012, rreth lejimit të rregullimit të infrastrukturës në fshatin turistik Prevallë, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-11514
Më 23.10.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor për formimin e Komisionit për vlerësimin e gjendjes në kampingun në Prevallë, kryetari i Komunës, më 23 tetor 2012, miratoi këtë:

AKTVENDIM

I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor për formimin e Komisionit për vlerësimin e gjendjes në kampingun në Prevallë. Për anëtarë të këtij Komisioni, emërohen: 1. Refki Muzbegu, nga DUPH, 2. Hasan Hasani, drejtor i DSHP, 3. Aliismet Çoçaj, drejtor i DBZhR, 4. Gursel Skenderi, nga Prona, 5. Ferat Gjezairi, nga DGJK, 6. Sherife Çengaj, nga DZhET, 7. Enver Bytyqi nga DI. Drejtoria e Urbanizmit është udhëheqëse e këtij komisioni.

II. Komisioni nga pika I e këtij Aktvendimi do të bëjë vlerësimin e gjendjes në kampingun në Prevallë, të vlerësojë përmbushjen e obligimeve të kontratës lidhur në mes Komunës së Prizrenit dhe IS& Company lidhur me menaxhimin e këtij kampingu, si dhe të japë rekomandimet e nevojshme për menaxhimin e mëtutjeshëm të kampingut. Komisioni mund të marrë edhe veprime të tjera konform ligjit.

III. Ky Komision, për punën e bërë, do të raportojë me shkrim para organeve kompetente të Komunës së Prizrenit dhe do të japë rekomandimet dhe propozimet e veta në afat prej 1 muaji, nga dita e marrjes së këtij Aktvendimi

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe të emëruarit.

Me këtë Aktvendim të njoftohen Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, të emëruarit dhe Arkivi.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-11514
Më 23.10.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 23.10.2012 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, bazuar në kërkesën e Begush Bajramit, rreth lirit nga pagesa e kontributit për rregullimin e tokës ndërtimore (komunaliet) lidhur me ndërtimin e objektit- shtëpi familjare, dhe mori këtë

KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, bazuar në kërkesën e Begush Bajramit, me banim në rr. "Gjin Muzaka" rreth lirit nga pagesa e kontributit për rregullimin e tokës ndërtimore (komunaliet) lidhur me ndërtimin e objektit- shtëpi familjare. Kështu që, obliguesi i kësaj takse, Begush Bajrami, lirohet nga taksa e lartcekur, e cila i është caktuar nga shërbimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor.

Lirimi nga pagesa e kontributit për rregullimin e tokës ndërtimore (komunaliet), e cila është 191.00 €, konsiderohet si participim (donacion) i Kuvendit të Komunës në ndërtimin e këtij objekti.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Financave, e Ekonomisë dhe e Zhvillimit.

Me këtë konkluzion të njoftohen Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Financave, e Ekonomisë dhe e Zhvillimit, dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-11514
Më 23.10.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 23.10.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, të datës 2.10.2012, rreth lejimit të shpalljes së tenderit për dekorimin e qytetit për festat e fundvitit, dhe mori këtë

KONKLUZION


Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 2.10.2012, rreth lejimit të dekorimit të qytetit për festat e fundvitit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

The image shows an official circular stamp of the Municipality of Prizren, Kosovo. The stamp contains the text: "REPUBLIKA E KOSOVËS", "KOMUNA E PRIZRENIT", "Kryetari i Komunës", and "Prof. dr. Ramadan Muja". A handwritten signature is written over the stamp.

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-11514
Më 23.10.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 23.10.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës, të datës 15.10.2012, rreth lejitimit të shpalljes së tenderit për furnizim me karburante për nevojat e Komunës së Prizrenit, dhe mori këtë

KONKLuzion


Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, i datës 15.10.2012, rreth lejitimit të furnizimit me karburante për nevojat e Komunës së Prizrenit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Rrahman Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-11514
Më 23.10.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 23.10.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Zyrës për Marrëdhënie me Publikun, të datës 23.10.2012, rreth lejimit të shpalljes së tenderit për përkthimin dhe botimin e Kumtarit për vitin 2012, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Zyrës për Marrëdhënie me Publikun, i datës 23.10.2012, rreth lejimit të përkthimit të akteve të kryetarit të Komunës dhe të akteve të Kuvendit të Komunës të vitit 2012 nga gjuha shqipe në gjuhën boshnjake dhe nga gjuha shqipe në gjuhën turke si dhe për botimin e kumtarit për vitin 2012 në të tri gjuhët zyrtare të komunës së Prizrenit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Zyra për Marrëdhënie me Publikun, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Zyra për Marrëdhënie me Publikun, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-11514
Më 23.10.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të nënkryetarit të Komunës së Prizrenit për formimin e Komisionit për shitjen e ish aseteve të EULEX-it në Prizren, me ankand publik, kryetari i Komunës, më 23 tetor 2012, miratoi këtë:

AKTVENDIM

I. Formohet dhe emërohet Komisioni për shitjen e ish aseteve të EULEX-it në Prizren me ankand publik. Për anëtarë të këtij Komisioni, emërohen: 1. Nezir Rexhepi, kryetar i Komisionit, 2. Zeqir Xhaferi dhe 3. Sadik Tahiri, anëtarë.

II. Detyrat e Komisionit do të jenë: të organizojë dhe realizojë shitjen e ish aseteve të EULEX-it, të përpilojë procesverbalin lidhur me ecurinë e shitjeve të këtyre aseteve, etj.

III. Komisioni, nga pika I e këtij Aktvendimi, do t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e veta në pajtim me ligjin në fuqi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimt të këtij aktvendimi.

Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen nënkryetari i Komunës dhe të emëruarit.

Me këtë Aktvendim të njoftohen nënkryetari i Komunës, të emëruarit dhe Arkivi.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-zyrtar
Më 16.10.2012

Kryetari i Komunës, pas propozimit të Drejtorisë së Administratës të datës 15.10.2012, rreth lejimit të shpalljes së tenderit për renovimin e objekteve të Komunës së Prizrenit- renovimi i objekti të ish Arkivit në Prizren, mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës i datës 15.10.2012, rreth lejimit të renovimit të objekteve të Komunës së Prizrenit- renovimit të objekti të ish Arkivit në Prizren, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

